

VENDIM
Nr. 793, datë 7.10.2020

**PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE TË POSAÇME E TË KRITEREVE TË
LICENCIMIT, DOKUMENTEVE SHOQËRUESE DHE PROCEDURAVE PËR
SHQYRTIMIN OSE REVOKIMIN E LICENCËS PËR VEPRIMTARINË
ARKEOLOGJIKE DHE VEPRIMTARINË ARKEOLOGJIKE NËNUJORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 136, pika 4, 137, pika 1, dhe 157, pikat 5 dhe 6, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e kushteve të posaçme të licencimit, kriterëve, dokumenteve shoqëruese dhe procedurave për shqyrtimin ose revokimin e licencës për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Kreu III, i “Rregullores mbi kriteret e ushtrimit të profesionit të arkeologut, kriteret e gërmimit, dokumentimit dhe arkivimit të të dhënave dhe materialeve arkeologjike”, miratuar me vendimin nr. 2, datë 30.1.2009, të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë, të ndryshuar, shfuqizohet.

3. Ngarkohet ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

**KUSHTET E POSAÇME TË LICENCIMIT, KRITERET, DOKUMENTET SHOQËRUESE,
SI DHE PROCEDURAT PËR SHQYRTIMIN OSE REVOKIMIN E LICENCËS PËR
VEPRIMTARINË ARKEOLOGJIKE DHE VEPRIMTARINË ARKEOLOGJIKE NËNUJORE**

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti dhe fusha e veprimit

Ky vendim përcakton dhe shtrin fushën e veprimit në:

- a) llojet e licencave dhe kushtet e posaçme për licencim për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore për individin, personin fizik dhe personin juridik;
- b) dokumentacionin për pajisjen me licencë;
- c) procedurën për shqyrtimin për dhënien ose revokimin e licencës për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore.

KREU II
LLOJET, KATEGORITË E LICENCEVE DHE KUSHTET PËR LICENCIM

Neni 2

Llojet dhe kategoritë e licencave për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore

1. Licencë për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore është akti administrativ, që i njeh titullarit të saj të drejtën të fillojë e të ushtrojë tipin e veprimtarisë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në të.

2. Llojet e licencave për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore janë:

- a) licenca për veprimtarinë arkeologjike dhe/ose veprimtarinë arkeologjike nënujore për individin;
- b) licenca për veprimtarinë arkeologjike dhe/ose veprimtarinë arkeologjike nënujore për personin fizik;
- c) licenca për veprimtarinë arkeologjike dhe/ose veprimtarinë arkeologjike nënujore për personin juridik.

3. Licencat për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore për individin, personin fizik dhe juridik, jepen për këto kategori:

- a) A. Për veprimtarinë arkeologjike:
 - i. A1. Vëzhgim arkeologjik (*Survey*);
 - ii. A2. Sondazhe arkeologjike;
 - iii. A3. Gërmim arkeologjik.
- b) B. Për veprimtarinë arkeologjike nënujore:
 - i. B1. Vëzhgim arkeologjik (*Survey*) nënujor;
 - ii. B2. Sondazh arkeologjik nënujor;
 - iii. B3. Gërmim arkeologjik nënujor.

Neni 3

Kushtet e posaçme për licencim për individin

1. Për të përfituar licencë me kategorinë A1 - Vëzhgim arkeologjik (*Survey*), individi duhet:

- a) të zotërojë diplomë të ciklit të dytë në arkeologji ose histori, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë apo të ketë diplomën ekuivalente, të njohur dhe të njësuar sipas legjislacionit në fuqi;
- b) të ketë eksperiencë si pjesëmarrës në të paktën 5 (pesë) projekte për veprimtari arkeologjike (*survey*/ekspedita arkeologjike) brenda dhe/ose jashtë vendit, e vërtetuar nga institucioni apo drejtuesi i projektit bashkë me dokumentacionin e projektit të miratuar.

2. Për të përfituar licencë me kategorinë A2 - Sondazh arkeologjik, individi duhet:

- a) të zotërojë diplomë të ciklit të dytë në arkeologji ose histori, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë apo të ketë diplomën ekuivalente, të njohur dhe të njësuar sipas legjislacionit në fuqi;
- b) të jetë pjesë e ekipit të realizimit të sondazheve brenda dhe/ose jashtë vendit, e vërtetuar nga institucioni apo bashkautor i projektit bashkë me dokumentacionin e projektit të miratuar në të paktën 5 (pesë) projekte arkeologjike gërmimi-shpëtimi, projekte kërkimore-shkencore.

3. Për të përfituar licencë me kategorinë A3 - Gërmim arkeologjik, individi duhet:

- a) të zotërojë diplomë të ciklit të dytë në arkeologji ose histori, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë apo të ketë diplomën ekuivalente, të njohur dhe të njësuar sipas legjislacionit në fuqi;
- b) të jetë autor/bashkautor në të paktën 6 (gjashtë) projekte, brenda dhe/ose jashtë vendit, ku në 3 prej tyre të ketë qenë drejtues projekti, vërtetuar nga institucioni apo drejtuesi i projektit bashkë me dokumentacionin e projektit të miratuar.

ose

a/1 të zotërojë diplomë “Doktor i shkencave” në fushën e arkeologjisë, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, të licencuara sipas dispozitave në fuqi apo të ketë njësuar pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin diplomën ekuivalente të lëshuar nga institucionet e huaja;

b/1 të jetë autor/ bashkautor në të paktën 4 (katër) projekte, brenda dhe/ose jashtë vendit, ku në 3 prej tyre të ketë qenë drejtues projekti, vërtetuar nga institucioni apo drejtuesi i projektit bashkë me dokumentacionin e projektit të miratuar.

4. Për të përfituar licencë me kategorinë B1 - Vëzhgim arkeologjik (*Survey*) nënujor, individit duhet:

a) të zotërojë diplomë të ciklit të dytë në arkeologji ose histori, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë apo të ketë diplomën ekuivalente, të njohur dhe të njësuar sipas legjislacionit në fuqi;

b) të zotërojë gradën e tretë të zhytësit ose superiore, të mbrojtur në një nga shkollat didaktike të njohura, si: SSI, CMAS, PADI, ose të ngjashme;

c) të zotërojë dokumentin për sigurimin e jetës në standardet e Agjencisë Ndërkombëtare për Sigurimin e Zhytëseve DAN EUROPE;

ç) të ketë eksperiencë si pjesëmarrës në të paktën 3 (tri) projekte për veprimtari arkeologjike nënujore, brenda dhe/ose jashtë vendit, e vërtetuar nga institucioni apo drejtuesi i projektit bashkë me dokumentacionin e projektit të miratuar.

5. Për të përfituar licencë me kategorinë B2 - Sondazh arkeologjik nënujor, individit duhet:

a) të zotërojë diplomë të ciklit të dytë në arkeologji ose histori, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, apo të ketë diplomën ekuivalente, të njohur dhe të njësuar sipas legjislacionit në fuqi;

b) të zotërojë gradën e tretë të zhytësit ose superiore, të mbrojtur në një nga shkollat didaktike të njohura, si: SSI, CMAS, PADI ose të ngjashme;

c) të zotërojë dokumentin për sigurimin e jetës në standardet e Agjencisë Ndërkombëtare për Sigurimin e Zhytëseve DAN EUROPE;

ç) të jetë autor/bashkautor në të paktën 3 (tri) projekte arkeologjike nënujore brenda dhe/ose jashtë vendit, e vërtetuar nga institucioni apo drejtuesi i projektit bashkë me dokumentacionin e projektit të miratuar.

6. Për të përfituar licencë me kategorinë B3 - Gërmim Arkeologjik nënujor, individit duhet:

a) të zotërojë diplomë të ciklit të dytë në arkeologji ose histori, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, apo të ketë diplomën ekuivalente, të njohur dhe të njësuar sipas legjislacionit në fuqi;

b) të zotërojë gradën e tretë të zhytësit ose superiore, të mbrojtur në një nga shkollat didaktike të njohura si: SSI, CMAS, PADI, ose të ngjashme;

c) të zotërojë dokumentin për sigurimin e jetës në standardet e Agjencisë Ndërkombëtare për Sigurimin e Zhytëseve DAN EUROPE;

ç) të jetë autor në të paktën 6 (gjashtë) projekte brenda dhe/ose jashtë vendit, ku në 3 prej tyre të ketë qenë drejtues projekti vërtetuar nga dokumenti i konfirmuar (origjinal ose fotokopje e noterizuar) nga institucioni apo drejtuesi i projektit bashkë me dokumentacionin e projektit të miratuar.

ose

a/1) të zotërojë diplomë “Doktor i shkencave” në fushën e arkeologjisë, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë të licencuara sipas dispozitave në fuqi, apo të ketë njësuar pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin diplomën ekuivalente, të lëshuar nga institucionet e huaja;

b/1) të zotërojë gradën e tretë të zhytësit ose superiore, të mbrojtur në një nga shkollat didaktike, të njohura si: SSI, CMAS, PADI, ose të ngjashme;

c/1) të zotërojë dokumentin për sigurimin e jetës në standardet e Agjencisë Ndërkombëtare për Sigurimin e Zhytëseve DAN EUROPE;

ç/1) të jetë autor/bashkautor në të paktën 4 (katër) projekte, brenda dhe/ose jashtë vendit, ku në 3 prej tyre të ketë qenë drejtues projekti, vërtetuar nga institucioni apo drejtuesi i projektit bashkë me dokumentacionin e projektit të miratuar.

Neni 4

Kriteret për pajisjen me licencë dhe ushtrimin e veprimtarisë arkeologjike dhe/ose veprimtarisë arkeologjike nënujore

1. Çdo subjekt individ, si dhe çdo person fizik apo juridik, i regjistruar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi për veprimtarinë tregtare për ushtrimin e veprimtarisë arkeologjike dhe/ose veprimtarisë arkeologjike nënujore, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për pajisje me licencë për veprimtarinë arkeologjike dhe/ose veprimtarinë arkeologjike nënujore, pasi të ketë dorëzuar aplikimin e plotë pranë sekretarisë teknike të KKTKM-së, duke plotësuar të gjitha kushtet e posaçme dhe dokumentet shoqëruese, të kërkuara në këtë vendim.

2. Veprimtaria arkeologjike dhe/ose veprimtaria arkeologjike nënujore ushtrohet vetëm nga persona fizikë ose juridikë, të regjistruar sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar në fuqi për regjistrimin e biznesit.

3. Individët e pajisur me licencë mund të ushtrojnë veprimtarinë arkeologjike dhe/ose veprimtarinë arkeologjike nënujore vetëm duke qenë të regjistruar si person fizik ose të punësuar si drejtues teknik pranë një personi fizik ose juridik, i regjistruar sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar në fuqi për veprimtarinë tregtare.

4. Kriteret për pajisjen me licencë për veprimtarinë arkeologjike dhe/ose veprimtarinë arkeologjike nënujore për personin fizik janë:

a) të jetë regjistruar si person fizik me status aktiv, sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar në fuqi për regjistrimin e veprimtarisë tregtare, me objekt të veprimtarisë hulumtimet arkeologjike dhe/ose arkeologjike nënujore;

b) të ketë një licencë si individ ose të ketë të punësuar si drejtues teknik individ të licencuar në fushën e veprimtarisë arkeologjike dhe/ose veprimtarisë arkeologjike nënujore;

c) të licencohet për kategorinë/kategoritë e licencës për veprimtarinë arkeologjike dhe/ose veprimtarinë arkeologjike nënujore që disponon individ/drejtuesi teknik.

5. Kriteret për pajisjen me licencë për veprimtarinë arkeologjike dhe/ose veprimtarinë arkeologjike nënujore për personin juridik janë:

a) të jetë regjistruar si person juridik me status aktiv, sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar në fuqi për regjistrimin e veprimtarisë tregtare, me objekt të veprimtarisë hulumtimet arkeologjike dhe/ose arkeologjike nënujore;

b) të ketë të paktën 5 vjet përvojë si person juridik në veprimtarinë kryesore hulumtimet arkeologjike dhe/ose arkeologjike nënujore;

c) të ketë të punësuar si drejtues teknik individ të licencuar në fushën e veprimtarisë arkeologjike dhe/ose veprimtarisë arkeologjike nënujore;

ç) të licencohet për kategorinë/kategoritë e licencës për veprimtarinë arkeologjike dhe/ose veprimtarinë arkeologjike nënujore që disponon drejtuesi teknik.

6. Drejtues teknik është personi i cili plotëson kushtet e posaçme për kategorinë/kategoritë e licencës, të parashikuara në nenin 3, të këtij vendimi.

7. Kontrata e punësimit ndërmjet personit fizik ose juridik dhe drejtuesit teknik nuk mund të jetë më pak se 1 vit.

Neni 5

Kufizime për dhënien dhe përdorimin e licencës

1. Licenca nuk lejohet të tjetërsohet apo të trashëgohet nga një subjekt (individ, person fizik ose person juridik) tek tjetri.

2. Kur ndodh ndryshimi faktik i të dhënave të përcaktuara në licencë, të cilat kanë të bëjnë me kriteret e licencimit, pavarësisht se mund të cenohet apo jo këto kritere, subjekti (individ, person fizik, person juridik) duhet të njoftojë menjëherë sekretarinë teknike të KKTKM-së, pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (në vijim “IKTK”).

3. Kur vlerësohet se dokumentet e dorëzuara nga subjekti (individ, person fizik, person juridik) provojnë përmbushjen përsëri të kriterëve të licencimit, atëherë KKTKM-ja miraton ndryshimet dhe subjekti pajiset me licencën e ndryshuar. Përdorimi i licencës pezullohet për periudhën deri në miratimin e ndryshimeve dhe pajisjen me licencën e ndryshuar.

4. Anëtarët e KKTKM-së dhe punonjësit e institucioneve të specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore nuk mund të aplikojnë për licencë për sa kohë mbajnë këtë detyrë.

5. Subjektet e licencuara për veprimtarinë arkeologjike dhe/ose veprimtarinë arkeologjike nënujore, kur emërohen anëtarë të KKTKM-së apo punësohen në institucione të specializuara në fushën e trashëgimisë kulturore në varësi të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, pezullojnë licencën e tyre për sa kohë ushtrojnë një nga këto funksione.

Neni 6

Afatet e vlefshmërisë së licencës

1. Licenca për veprimtarinë arkeologjike dhe/ose veprimtarinë arkeologjike nënujore është pa afat për të gjitha subjektet e licencuara.

2. Subjekti, person fizik apo juridik, njofton në formë zyrtare në sekretarinë teknike të KKTKM-së, pranë IKTK-së:

- a) menjëherë, kur kontrata e punësimit të drejtuesit teknik ndërpritet përpara afatit;
- b) të paktën 45 (dyzet e pesë) ditë përpara mbarimit të kontratës së punësimit të drejtuesit teknik, nëse kjo kontratë do të ripërtërihet;
- c) të paktën 45 (dyzet e pesë) ditë përpara mbarimit të kontratës së punësimit të drejtuesit teknik, nëse kjo kontratë nuk do të ripërtërihet.

KREU III

DOKUMENTET SHOQËRUESE PËR PAJISJEN ME LICENCË

Neni 7

Dokumente shoqëruese për pajisjen me licencë për individin

Kërkesa për pajisje me licencë për herë të parë për individin, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet e posaçme të përcaktuara në këtë vendim, shoqërohet me:

- a) kërkesën për pajisje me licencë, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;
- b) kopje të dokumentit të identifikimit;
- c) CV-në e individit, ku pasqyrohet veprimtaria e tij e kryer nga marrja e diplomës, e shoqëruar me dokumentacionin justifikues, vërtetime nga subjekte publike apo private, shqiptare apo të huaja, projekte ku personi ka qenë autor dhe/ose bashkautor, certifikata kursi apo specializimi, që kanë lidhje me fushën ku kërkon të licencohet. Të gjitha vërtetimet dhe projektet duhet të kenë patjetër të përfshirë adresën postare dhe elektronike të subjektit që ka lëshuar vërtetimin apo që ka hartuar projektin. Vërtetimet që nuk janë sipas parashikimeve në këtë shkronjë konsiderohen si dokument i pavlefshëm për qëllimin e kërkuar;
- ç) dokument që vërteton kohën/vitet e punës (libreza e punës apo dokumente të tjera që vërtetojnë kohën/vitet e punës);

- d) vetëdeklarim mbi gjendjen e tij gjyqësore dhe penale;
- dh) dy fotografi me përmasa 3x4 cm;
- e) kopje të diplomave që zotëron, certifikata kursi apo specializimi, të noterizuara;
- ë) dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës, për kërkesën për pajisjen me licencë për individ, për veprimtarinë arkeologjike dhe/ose veprimtarinë arkeologjike nënujore.

Neni 8

Dokumente shoqëruese për pajisjen me licencë për personin fizik

Kërkesa për pajisje me licencë për personin fizik, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet e posaçme të specifikuara në këtë vendim, shoqërohet me:

- a) kërkesën për pajisje me licencë, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;
- b) certifikatën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- c) kopje të dokumentit të identifikimit të kërkuarit;
- ç) CV-në e personit, ku pasqyrohet veprimtaria e tij e kryer nga marrja e diplomës, e shoqëruar me dokumentacionin justifikues, vërtetime nga subjekte publike apo private, shqiptare apo të huaja, projekte ku personi ka qenë autor dhe/ose bashkautor, certifikata kursi apo specializimi, që kanë lidhje me fushën ku kërkon të licencohet. Të gjitha vërtetimet dhe projektet duhet të kenë patjetër të përfshirë adresën postare dhe elektronike të subjektit që ka lëshuar vërtetimin apo që ka hartuar projektin, në të kundërt dokumenti nuk do të konsiderohet si dokument justifikues për eksperiencën. Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të përkthehen sipas rregullave të parashikuara në nenin 135, të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë”;

- d) vetëdeklarimin e personit fizik mbi gjendjen e tij gjyqësore dhe penale;
- dh) dy fotografi me përmasa 3x4 cm;
- e) vetëdeklarim nga drejtuesi teknik, për:
 - i. gjendjen gjyqësore dhe penale;
 - ii. gjendjen në lidhje me punësimin si drejtues teknik në persona fizikë apo juridikë të tjerë;
 - iii. marrëdhënien e tij të punës me institucionet shtetërore qendrore, vendore, të pavarura, apo persona juridikë publikë të tjerë;
- ë) në rastin e punësimit të drejtuesit teknik, kontratën e lidhur midis personit fizik dhe drejtuesit teknik në fushën e veprimtarisë arkeologjike dhe/ose nënujore;
- f) dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për kërkesën për pajisjen me licencë për personin fizik për veprimtarinë arkeologjike dhe/ose veprimtarinë arkeologjike nënujore.

Neni 9

Dokumente shoqëruese për pajisje me licencë për personin juridik

Kërkesa për pajisje me licencë për personin juridik, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet e posaçme të specifikuara në këtë vendim, për secilën kategori, shoqërohet me:

- a) kërkesë të përfaqësuesit ligjor të personit juridik, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;
- b) certifikatën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- c) vetëdeklarimin mbi gjendjen gjyqësore dhe penale (të anëtarëve të organit administrativ, aksionarit ose ortakut, të personit që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda personit juridik);
- ç) kontratë punësimi midis përfaqësuesit ligjor dhe drejtuesit teknik në fushën e veprimtarisë arkeologjike dhe/ose nënujore;
- d) vetëdeklarim i drejtuesit teknik në fushën e veprimtarisë arkeologjike dhe/ose nënujore në cilësinë e drejtuesit/drejtuesve teknikë, për:

- i. gjendjen e tij gjyqësore dhe penale;
- ii. gjendjen në lidhje me punësimin si drejtues teknik në persona juridik të tjerë, që ushtrojnë veprimtari në fushën e arkeologjisë;
- iii. marrëdhënien e tij të punës me institucionet shtetërore qendrore, vendore, të pavarura apo persona juridikë të tjerë publikë;
- dh) dokumentacionin e drejtuesit teknik të punësuar, që provon plotësimin e kushteve të posaçme për kategorinë/kategoritë e licencës, të parashikuara në nenin 3, të këtij vendimi;
- e) dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për kërkesën për pajisjen me licencë për personin juridik për veprimtarinë arkeologjike dhe/ose veprimtarinë arkeologjike nënujore.

Neni 10

Dokumente shoqëruese për shtesa në kategori dhe ndryshim të licencës

1. Kërkesa për pajisje me shtesa në kategori dhe ndryshim të licencës, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet e posaçme e të përgjithshme, të specifikuara në këtë vendim, shoqërohet me:
 - a) kërkesën për pajisje me shtesa në kategori dhe ndryshim të licencës, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;
 - b) dokumentacionin përkatës që provon përmbushjen e kriterëve;
 - c) dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për shtesa në kategori dhe ndryshim të licencës.
2. Në rastin kur ndryshimi që kërkohet ka lidhje me shtesa në kategori me qëllim pajisjen me licencë të re, subjekti duhet të dorëzojë licencën ekzistuese. Licenca ekzistuese shpallet e pavlefshme dhe lëshohet licencë e re me shtesat. Licenca e shpallur e pavlefshme shënjohe nga sekretaria teknike e KKTKM-së me prerje në anë dhe arkivohet në dosjen e subjektit.
3. Në rastin kur ndryshimi që kërkohet ka lidhje me ndërrimin e drejtuesit teknik, përfaqësuesve ligjorë, ndryshim të emrit apo selisë, mbarimin e afatit të kontratës së punësimit apo ripërtëritjen e afatit të kontratës së punësimit, me qëllim pajisjen me licencë të re, subjekti duhet të dorëzojë licencën ekzistuese. Licenca ekzistuese shpallet e pavlefshme dhe lëshohet licencë e re. Licenca e shpallur e pavlefshme shënjohe nga sekretaria teknike e KKTKM-së me prerje në anë dhe arkivohet në dosjen e subjektit.

Neni 11

Dokumente shoqëruese për pajisje me zëvendësim licence në rast humbjeje ose dëmtimi të ekzistueses

1. Kërkesa për pajisjen me zëvendësim licence në rast humbjeje ose dëmtimi të ekzistueses, pasi të plotësohen kufizimet dhe kushtet e posaçme, të specifikuara në këtë vendim, shoqërohet me:
 - a) kërkesën për pajisje me zëvendësim licence në rast humbjeje ose dëmtimi të ekzistueses, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi;
 - b) dy fotografi për dokument;
 - c) dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për kërkesën për pajisje me zëvendësim licence në rast humbjeje ose dëmtim të ekzistueses.
2. Në rastin kur kërkesa ka lidhje me zëvendësimin e licencës së dëmtuar me qëllim pajisjen me licencë të re, subjekti duhet të dorëzojë licencën ekzistuese të dëmtuar.
3. Licenca e dëmtuar dhe ajo e humbur shpallet e pavlefshme dhe lëshohet licencë e re, me të dhëna të njëjta dhe me datë lëshimi të re.

KREU IV
PROCEDURAT PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS, DHËNIEN, PEZULLIMIN OSE
REVOKIMIN E LICENCËS PËR VEPRIMTARINË ARKEOLOGJIKE DHE
VEPRIMTARINË ARKEOLOGJIKE NËNUJORE

Neni 12

Dorëzimi dhe pranimi i kërkesave

1. Kërkesa për licencë dhe dokumentet shoqëruese të saj dërgohen nëpërmjet sistemit informatik të integruar për shërbimet e licencimit për veprimtari arkeologjike dhe veprimtari arkeologjike nënujore, që funksionon pranë portalit unik të shërbimeve qeveritare *e-Albania*.

2. Dokumentet për licencë, që ngarkohen në sistem, duhet të jenë:

- a) origjinale ose kopje të noterizuara të origjinalit;
- b) në gjuhën shqipe ose të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes zyrtarë dhe të njësuar me origjinalin nga noteri;
- c) për rastet e dokumenteve të huaja, kopje të vërtetuara nga një autoritet publik i juridiksionit të huaj (zyrtar/noter). Është detyrim të vërtetohet ekzistenca e tyre si zyrtarë apo noterë, nëpërmjet legalizimit apo apostilimit, sipas ligjeve në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

3. Pagesa e tarifës për përfitimin e licencës kryhet nëpërmjet sistemit informatik të integruar për shërbimet e licencimit për veprimtari arkeologjike dhe arkeologjike nënujore, që funksionon pranë portalit unik të shërbimeve qeveritare *e-Albania*, ose pranë çdo banke të nivelit të dytë, nëpërmjet formularit të faturës për arkëtim.

4. Paraqitja fizike e një apo disa dokumenteve pranë sportelit unik do të kryhet vetëm në këto raste:

- a) për dorëzimin e fotografive të individit që aplikon, të cilat dorëzohen fizikisht nga kërkuesi, deri në momentin e tërheqjes së formularit të licencës;
- b) për dorëzimin e licencës paraardhëse, në rastet e parashikuara në këtë vendim;
- c) kur kërkohet verifikim i dokumentit/dokumenteve nga sekretaria teknike e KKTKM-së.
- ç) për çdo rast, i cili nuk njihet ose nuk mund të parashikohet në momentin e miratimit të këtij vendimi.

Neni 13

Shqyrtimi i kërkesave

1. Kërkesa për dhënie ose revokim të licencës për shtesa në kategori dhe ndryshim të licencës dhe për pajisje me zëvendësim licence në rast humbjeje ose dëmtimi të ekzistueses, bashkë me dokumentet shoqëruese të saj sipas këtij vendimi, administrohen nga sporteli unik dhe sekretaria teknike e KKTKM-së, pranë IKTK-së.

2. Procedura e administrimit të kërkesës dhe shqyrtimit të saj deri në vendimmarrje me miratim ose jo të kërkesës realizohet sipas rregullave të funksionimit të KKTKM-së, përcaktuar në “Rregulloren për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, sekretarisë teknike dhe sportelit unik të saj”, miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

3. KKTKM-ja merr vendim mbi kërkesën sipas rastit, licencim ose revokim të licencës për shtesa në kategori dhe ndryshim të licencës dhe për pajisje me zëvendësim licence në rast humbjeje ose dëmtimi të ekzistueses, brenda 45 ditëve nga regjistrimi i kërkesës.

4. Ndaj vendimit të KKTKM-së mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

5. Sekretaria teknike bën shpërndarjen e licencave të interesuarve jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e urdhrit të ministrit, nëpërmjet shërbimit postar ose licencat tërhiqen nga vetë personi i licencuar apo nga persona të autorizuar me akt noterial për të kryer një veprim të tillë apo personat e autorizuar nga personi juridik. Kopja e autorizimit depozitohet në dosjen që arkivohet.

6. Licenca e miratuar për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore për shtesa në kategori/nënkategori dhe ndryshim të licencës për pajisje me zëvendësim licence në rast humbjeje ose dëmtimi të ekzistueses, si dhe çdo vendim për pezullim apo revokim të licencës regjistrohet në Regjistrin e Licencave për veprimtarinë ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, i cili administrohet nga IKTK-ja, si dhe në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 14

Detyrimi i formimit të vazhdueshëm

1. Individit i licencuar ka detyrimin të kryejë formimin e vazhdueshëm ose të marrë kreditet në përputhje me pikat 2 dhe 3, të nenit 137, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

2. Brenda datës 31 janar të çdo viti, individit i licencuar raporton pranë sekretarisë teknike mbi plotësimin e krediteve për vitin ushtrimor paraardhës, sipas parashikimit të pikës 1, të këtij neni.

Neni 15

Revokimi dhe pezullimi i licencës

1. Licenca revokohet në rastet e parashikuara në pikën 3, të nenit 137, pikën 1, të nenit 138, dhe pikën 7, të nenit 157, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

2. Licenca revokohet edhe në rastin kur personi fizik ose personi juridik mbyll aktivitetin. Në këtë rast, subjekti paraqet pranë sekretarisë teknike të KKTKM-së dokumentacionin, si më poshtë:

- a) Njoftim me shkrim nga përfaqësuesi ligjor për mbylljen e aktivitetit;
- b) Dorëzimin e licencës për veprimtarinë arkeologjike dhe/ose veprimtarinë arkeologjike nënujore që disponon;
- c) Dokument vërtetues nga QKB-ja për çregjistrimin e subjektit nga Regjistri Tregtar.

3. Për çdo rast të konstatuar, IKTK-ja harton një raport vlerësimi të fakteve dhe ia kalon për shqyrtim KKTKM-së, që merr vendim për revokimin e licencës për veprimtarinë arkeologjike dhe/ose veprimtarinë arkeologjike nënujore.

4. Përdorimi i licencës pezullohet në rastet kur titullari i saj ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit ose ka ndonjë pengesë tjetër ligjore me ushtrimin e funksioneve publike, në përputhje me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

5. Licenca për veprimtarinë arkeologjike dhe/ose veprimtarinë arkeologjike nënujore pezullohet me vendim të KKTKM-së për çdo konstatim të rasteve të përmendura në këtë nen dhe që nuk përbëjnë shkak për revokim për periudhën kohore që ekziston shkaku që ka çuar në pezullim.

6. Kundër vendimit për revokimin ose pezullimin e licencës mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

KREU V DISPOZITA KALIMTARE

Neni 16

1. Për çdo individ, person fizik ose person juridik, të licencuar në arkeologji, të cilit i është miratuar licenca nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë ose nga KKTKM-ja përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi, licenca do të konsiderohet e vlefshme deri 6 muaj nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. Brenda këtij afati subjektet duhet të bëjnë rinovimin e licencave me formatin e ri të kategorive, si dhe në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë rregullore. Pas këtij afati, licencat e parinovuara janë të pavlefshme.

2. Të gjitha subjektet, të cilat kanë paraqitur kërkesë për licencë për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore dhe nuk janë shqyrtuar nga KKTKM-ja përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi duhet të dorëzojnë dokumentacionin plotësues për të provuar plotësimin e kushteve për licencim sipas këtij vendimi, brenda afatit 31.12.2020.

3. Të gjitha kërkesat për licencë për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore, si dhe aktet formale në lidhje me to bëhen me pagesë, sipas tarifave të miratuara me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe ministrit përgjegjës për financat.

4. Ngarkohet KKTKM-ja për miratimin e formatit të licencave, të cilat konsiderohen dokumente me vlerë që i nënshtrohet prodhimit të posaçëm.

5. Licenca e miratuar për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore, si dhe çdo vendim për revokim dhe pezullim të licencës regjistrohet në regjistrin e licencave në fushën e arkeologjisë, i cili administrohet nga IKTK-ja, si dhe në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve.

6. Të gjitha kërkesat për licenca për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore dhe dokumentacioni shoqërues do të dërgohen në formë fizike nëpërmjet shërbimit postar pranë sportelit unik/sekretarisë teknike të IKTK-së deri në kalimin e të gjithë procedurës në sistemin elektronik për aplikimin *online* në portalin *e-Albania*.

FORMULAR APLIKIMI <i>Licencë për veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale</i> <i>Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore</i>					
<i>Institucioni përgjegjës:</i>					
1. APLIKUESI					
STATUSI I APLIKUESIT	INDIVID	PERSON FIZIK	PERSON JURIDIK		
2. INFORMACION SPECIFIK (KUR APLIKUESI ËSHTË INDIVID)					
INDIVID:	Emri	Mbiemri			
ID:					
Nr. tel. / cel.:					
Email:					
Adresa:					
2/1. INFORMACION SPECIFIK (KUR APLIKUESI ËSHTË PERSON FIZIK / PERSON JURIDIK)					
Emri i subjektit:					
NIPT:					
Administratori:	Emri	Mbiemri			
ID -Administratori:					
Nr. tel. / cel.:					
Email:					
Adresa:					
3. INFORMACION SPECIFIK MBI DREJTUESIN TEKNIK (KUR APLIKUESI ËSHTË PERSON FIZIK/PERSON JURIDIK)					
Drejtuksi teknik (DT):	Emri	Mbiemri	Tel.		
Nr. i licencës së DT:					
4. INFORMACION SPECIFIK MBI LICENCËN E KËRKUAR					
Kategoria e veprimtarisë arkeologjike nëntokësore dhe veprimtarisë arkeologjike nënujore për të cilën kërkohet licenca:	A. Veprimtari arkeologjike nëntokësore B. Veprimtari arkeologjike nënujore		A1. Vëzhgim arkeologjik (Survey) A2. Sondazhe arkeologjike A3. Gërmim arkeologjik B1. Vëzhgim arkeologjik (Survey) nënujor B2. Sondazh arkeologjik nënujor B3. Gërmim arkeologjik nënujor	Aplikim i ri	Aplikim për shtesa
Ndryshime të licencës:	Rinovim afati Ndryshim përfaqësuesi ligjor Ndryshim drejtuesi teknik Ndryshim të emrit apo selisë				
Zëvendësim të licencës ekzistuese:	Humbje Dëmtim				
Veprimtari specifike (punët e ngjashme për çdo kategori aplikimi):	1 2 3 4 5 6 7				
Vendi i kryerjes së veprimtarisë:					
6. KLAUZOLA DEKLARATIVE					
Vetëdeklarim mbi përgjegjësinë mbi veprimtarinë që do të kryejë individi					
Unë i/e nënshkruari/a _____ deklaroj se: - Të dhënat e deklaruara dhe dokumentet e dorëzuara janë të vërteta; - Drejtuesi teknik nuk punon në një shoqëri tjetër dhe nuk është në marrëdhënie pune me shtetin; - Subjekti njëh dhe pranon kriteret dhe detyrimet e licencimit.					
Vetëdeklarim mbi përgjegjësinë mbi veprimtarinë që do të kryejë subjekti					
Unë i/e nënshkruari/a _____ me cilësinë e administratorit të subjektit “ _____”, deklaroj se: - Të dhënat e deklaruara dhe dokumentet e dorëzuara janë të vërteta. - Drejtuesi teknik nuk punon në një shoqëri tjetër dhe nuk është në marrëdhënie pune me shtetin. - Subjekti njëh dhe pranon kriteret dhe detyrimet e licencimit.					
Vetëdeklarim mbi përgjegjësinë mbi veprimtarinë që do të kryejë individi (drejtues teknik)					
1. Unë i/e nënshkruari/a _____, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë, deklaroj se: - Nuk kam asnjë çështje gjyqësore të hapur dhe nuk jam në ndjekje penale nga organet e prokurorisë në lidhje me kategorinë e licencës ku kërkoj të licencohem; ose - Kam çështje gjyqësore të hapur në Gjykatën e Rrethit _____ (shoqëruar me motivin e çështjes) ose/dhe jam në ndjekje penale nga organi i Prokurorisë së Rrethit _____ (shoqëruar me motivin e ndjekjes). 2. Unë i/e nënshkruar/a _____, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë, deklaroj se: - Nuk kam asnjë penalizim nga strukturat shtetërore të ngarkuara për inspektimin ndërtimor e urbanistik; ose - Kam penalizim nga struktura shtetërore qendrore ose vendore _____ (shoqëruar me motivin e penalizimit).					
Vetëdeklarim mbi përgjegjësinë mbi veprimtarinë që do të kryejë subjekti					
1. Unë i/e nënshkruari/a _____ me cilësinë e administratorit të subjektit “ _____”, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë, deklaroj se: - Nuk kam asnjë çështje gjyqësore të hapur dhe nuk jam në ndjekje penale nga organet e prokurorisë në lidhje me kategorinë e licencës ku kërkoj të licencohem; ose - Kam çështje gjyqësore të hapur në Gjykatën e Rrethit _____ (shoqëruar me motivin e çështjes) ose/dhe jam në ndjekje penale nga organi i Prokurorisë së Rrethit _____ (shoqëruar me motivin e ndjekjes). 2. Unë i/e nënshkruari/a _____ me cilësinë e administratorit të subjektit “ _____”, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë, deklaroj se: - Nuk kam asnjë penalizim nga strukturat shtetërore të ngarkuara për inspektimin ndërtimor e urbanistik; ose - Kam penalizim nga struktura shtetërore qendrore ose vendore _____ (shoqëruar me motivin e penalizimit).					
Autorizimi i mëposhtëm është vullnetar					

Autorizoj institucionin të përpunojë të dhënat e mia personale (emër, mbiemër, numër telefoni ose <i>email</i>) të mbledhura më sipër, me qëllim zhvillimin e sondazheve të automatizuara për marrjen e opinionit tim, në lidhje me cilësinë e ofrimit të shërbimit.							
7. DOKUMENTACIONI I NGARKUAR							
1. Kontrata e punës ndërmjet subjektit (personi fizik apo personi juridik) dhe drejtuesit teknik të licencuar							
2. Deklaratë e drejtuesit teknik							
3. Mandatpagesa							
4. Dokumente të tjera							
8. DOKUMENTET / VERIFIKIMET / MIRATIMET QË SIGUROHEN NGA BASHKËVEPRIMI NDERINSTITUCIONAL							
1. Ekstrakt regjistrim biznesi nga QKB ose vendimin e regjistrimit në gjykatë							
2. Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të tatimore, taksave deri në momentin e paraqitjes së kërkesës (<i>nga bashkia dhe drejtoritë tatimore</i>)							
3. Fotokopje e licencës personale të drejtuesit teknik							
4. Verifikim / informacion për veprimtarinë arkeologjike të individëve nga DRTK-ja							
5. Verifikim / informacion për veprimtarinë arkeologjike të subjektit nga DRTK-ja (<i>jo për aplikim për berë të parë</i>)							
9. BAZA LIGJORE E KËTJ SHËRBIMI							
1. Ligji nr. 27/2018, datë 17.5.2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”							
2. VKM nr.____, datë _____.2020, “Për përcaktimin e kushteve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, si dhe procedurave për shqyrtimin dhe revokimin e licencës për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore”							
10. NJOFTIMI							
Marrja e informacionit:			Postë		Email	e-Albania	Sportel
Email (për njoftimin):							
Afati i njoftimit:		Jo më vonë se 10 ditë nga vendimi i KKTKM-së					